REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

# EKONOMIA DHE BUXHETI

# ECONOMY AND BUDGET

NENTOR – NOVEMBER
2006

TIRANE

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

# Raporti Mujor

## Nentor 2006

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

# PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…… …….13
   d. SEKTORI MONETAR……...……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

# 1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Nentor 2006, arriti ne 110.3 perqind, duke shenuar nje rritje mujore prej 0.8 përqind, pas renies prej 0.5 perqind dhe rritjes prej 0.8 perqind, perkatesisht ne muajt tetor dhe shtator. Norma vjetore e inflacionit, per muajin Nentor ishte 2.9 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankese se Shqiperise, prej 2 – 4 perqind.




- **Kursi mesatar i kembimit** te monedhes vendase me dy monedhat kryesore te huaja, per muajin Nentor 2006, ishte:

  - 96.50 leke per dollare
  - 123.99 leke per euro




Gjate muajit nentor, monedha vendase, u nencmua kundrejt monedhes europiane, Euros dhe u mbicmua kundrejt dollarit amerikan. Sjellja e monedhes sone ne tregun vendas eshte reflektimi i sjelljes se dy monedhave ne tregjet nderkombetare monetare si dhe i nderhyrjeve ne treg nga ana e Bankes se Shqiperise.

- Gjate muajit Nentor 2006, **normat e interesit te depozitave** 12-mujore ne leke, kane pesuar nje rritje ne vlere absolute prej 0.13 perqind krahasuar me muajin Tetor, ku normat e interesit ishin 5.20 perqind. Ne muajin Nentor 2006 normat e interesit te depozitave 12-mujore ne leke arriten koten e 5.33 perqind.

Rritje te lehte per kete muaj kane pesuan dhe depozitat me afat 6-mujor e krahasuara me muajin paraardhes (Tetor'06) me 0.01 perqind, si dhe normat e interesit per depozitat me afat 3 – mujor dhe 1 – mujor pesuan rritje respektivisht me nga 0.01 perqind dhe 0.31 perqind. Renie prej 0.09 perqind kane pesuar normat per depozitat me afat 24-mujor, te cilat arriten nivelin e 5.59 perqind.

Krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare, renien me te larte vjetore e kane patur normat e interesit te depozitave 6-mujore dhe 3-mujore, respektivisht me rreth 0.38 perqind dhe 0.31 perqind.




| | Nent '05 | Dhje '05 | Jan '06 | Shku '06 | Mars '06 | Prill '06 | Maj '06 | Qersh '06 | Korr '06 | Gusht '06 | Shtat '06 | Tet 06 | Nent 06 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12-M | 5.45 | 5.57 | 5.50 | 5.34 | 5.28 | 5.10 | 5.08 | 5.05 | 5.08 | 5.12 | 5.19 | 5.20 | 5.33 |
| 6-M | 4.89 | 4.77 | 4.95 | 4.71 | 4.80 | 4.60 | 4.46 | 4.35 | 4.23 | 4.26 | 4.31 | 4.50 | 4.51 |
| 3-M | 4.17 | 4.07 | 4.33 | 3.41 | 3.96 | 3.95 | 3.85 | 3.74 | 3.62 | 3.66 | 3.65 | 3.85 | 3.86 |

## ❖ Situata buxhetore

Ne fund te muajit Nentor 2006, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth -1.46 miliarde leke, ose rreth 3.96 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2006.
2. **Te ardhurat gjithsej** arriten ne rreth 202.5 miliarde leke ose rreth 88.08 perqind e programit vjetor 2006.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 203.98 miliarde leke, ose rreth 76.41 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2006.

**Treguesit Fiskale Nentor 2006**




❖ **Deficiti i pergjithshem** arriti ne -1.46 miliarde leke nga -13.24 miliarde leke te parashikuar per kete periudhe 11-mujore, duke tejkaluar kufijte e parashikuar.

❖ **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 88.08 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

- Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 88.51 përqind të programimit vjetor;
- Kontributet për sigurimet shoqërore prej 95.09 përqind;
- Të ardhurat jo-tatimore 76.09 përqind e buxhetit vjetor; dhe

- Të ardhurat nga pushteti lokal, 89.21 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 76.41 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 170.59 miliardë lekë ose rreth 83.51 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 91.92 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet sociale me rreth 87.99 përqind e buxhetit vjetor dhe i shpenzimeve operative dhe te mirembajtjes me rreth 80.20 perqind e buxhetit vjetor.

## a. Sektori Fiskal

### *Buxheti i Konsoliduar*

Ne fund te muajit Nentor, jane mbledhur rreth 202.52 miliarde leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 203.98 miliarde leke, qe perfshijne 170.5 miliarde leke ne shpenzime korente dhe 33.4 miliarde leke shpenzime kapitale.

Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e - 1.46 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben rreth 88.08 % te te ardhurave buxhetore per vitin 2006, ndersa shpenzimet perbejne 76.41 % te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 83.51 % e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 58.31 % e ketij planifikimi.
Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 140.7 miliarde leke (ose rreth 88.51 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 9.9 miliarde leke (89.2 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 35.4 miliarde leke (95 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 12.5 miliarde leke (76 % e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 170.59 miliarde leke, 488 miliarde leke (29 %) eshte shpenzuar per personelin, 23.2 miliarde leke (14 %) per interesat, 17.2 miliarde leke (10 %) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 2 miliarde leke (1 %) per subvencione, 53 miliarde leke (31 %) per shpenzimet e sigurimeve

shoqerore dhe shendetsore dhe 17 miliarde leke (10 %) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 9 miliarde leke (5 %) per shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 82.95 % (shpenzime personeli), 91.92 % (shpenzime per interesat), 80.2 % (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 81.2 % (subvencione), 87.99 % (sigurimet shoqerore dhe shendetsore), 73.67 % dhe 73.62 % (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 33.39 miliarde leke nga te cilat 64 % financim i brendshem, dhe 36 % financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem llogariten per kete periudhe ne rreth 57.76 % te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 59.32 %.

Deficiti prej 1.46 miliarde leke eshte i barabarte me 3.96 % te deficitit buxhetor per 2006.

## Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Nentor 2006 ne rreth 202.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 186.1 miliardë, grantet 3,836 milione dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 12.5 miliardë;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 140.7 miliardë lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 9.9 miliardë lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 35.4 miliarde leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Nentorut:

- TVSH përbënte 67.1 miliardë lekë
- Tatimi mbi fitimin 20.5 miliardë lekë
- Taksa doganore 12.9 miliardë lekë
- Taksat nacionale 11.9 miliardë lekë
- Akcizat 20.9 miliardë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 2.3 miliardë lekë;

## Financimi i Deficitit

Deficiti prej 1.46 miliardë lekë, ne fund te Nentorit, ishte -397 përqind me financim të brendshëm dhe +497 përqind me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

## ❖ Bilanci i pagesave

Bilanci i pagesave per nentemujorin 2006, rezultoi me nje sufiçit te pergjithshem prej 152.9 milion Usd. Kjo ishte rezultat i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej rreth 533.6 milion usd;
- suficiti te Llogarise se Kapitalit dhe Llogarise Financiare, prej rreth 358.0 milion usd
- bilanci pozitiv ne "Gabime dhe harresa neto" prej rreth 328.4 milion usd

Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 533.6 milion usd ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 1495.8 milion usd;
- defiçit prej 63.3 milion usd ne bilancin e sherbimeve;
- suficit prej 187.1 milion usd ne bilancin e te ardhurave;
- suficit prej 838.4 milion usd ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.

- **Oferta totale e parase,** e matur nga M3 arriti në 638 miliardë lekë në fund të muajit Nentor, duke shenuar një rritje prej rreth 13 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.




Kjo rritje vjetore, erdhi si pasoje e rritjes se **depozitave pa afat** ne leke me rreth 6 perqind, **depozitave ne valute** me rreth 24 perqind, **depozitave me afat** ne leke me rreth 13 perqind dhe rritjes te **parase jashte sistemit** me rreth 5 perqind.




Ndikimin kryesor ne rritjen e ofertes monetare gjate muajit Nentor e kane patur rritja e depozitave me afat ne leke, te cilat vetem gjate ketij muaji u rriten me rreth 2.38 miliarde leke si dhe depozitave pa afat ne leken me nje rritje prej rreth 0.84 miliarde leke kete muaj, ndersa depozitat ne valute pesuan nje renie per kete muaj me rreth 1.01 miliarde leke.

# 2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

## b. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

### *Indeksi i Çmimeve te Konsumit*

Indeksi i Cmimeve te Konsumit, per muajin Nentor '06 pesoi nje rritje prej 0.8 perqind, krahasuar me muajt Tetor dhe Shtator, kur ky indeks ishte perkatesisht 0.1 perqind dhe 0.6 perqind. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj te nje viti me pare ishin 0.2 perqind, 0.4 perqind dhe 0.9 perqind.

Rritjen me te madhe mujore, per kete muaj e shenoi grupi "Ushqime dhe pije jo alkolike" me 2.2 perqind, e cila erdhi si rezultat i rritjes te cmimeve per nengrupet "Zarzavate perfshire patatet" me 23.5 perqind dhe te nengrupit "Ushqime" me 2.3 perqind. Pesha specifike relativisht e larte qe ze ky grup ne shporten e mallrave te konsumit (rreth 42.6 perqind), ben qe ndikimi i kesaj rritjeje te jete i ndjeshem mbi noremen e inflacionit. Ndikimi i saj i drejteperdrejte ne inflacionin mujor ishte rreth 0.38 pike perqindjeje.

Gjate ketij muaji rritje shenoi edhe indeksi i cmimeve te grupit "Veshje dhe kepuce" me rreth 0.2 perqind, si rrjedhoje e rritjes se cmimeve te veshjeve per burra dhe gra, respektivisht me nga 0.4 perqind dhe 0.3 perqind, rritje e cila u shkaktua si pasoje e ndryshimit sezonal dhe afrimit te festave te fundvitit. Ndikimi i kesaj rritjeje ne inflacionin mujor ishte rreth 0.01 pike perqindjeje

Uljen me te madhe prej 0.3 perqind kete muaj e pesoi indeksi i cmimeve te grupit "Transporti", si rrjedhoje e uljes se cmimevit per nengrupin "sherbime ndaj mjeteve personale te transportit" me rreth 1.4 perqind, si dhe uljes se cmimit te karburanteve me 2.2 perqind.

Norma vjetore e inflacionit ne muajin Nentor arriti ne 2.9 perqind duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2005 dhe 2006 paraqiten ne tabelen e meposhtme :

| | Jan | Shku | Mars | Prill | Maj | Qer | Korr | Gusht | Shta | Tet | Nen | Dhj. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2005** | 3.3 | 1.8 | 1.6 | 1.3 | 2.0 | 2.9 | 1.8 | 2.3 | 3.1 | 3.3 | 3.0 | 2.0 |
| **2006** | 1.4 | 1.3 | 1.5 | 2.4 | 3.1 | 2.4 | 3.2 | 2.8 | 2.6 | 2.2 | 2.9 | |

## *Kursi mesatar i këmbimit*

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, gjate muajit Nentor shenoi nje renie te theksuar prej 1.19 perqind kundrejt muajit Tetor 2006. Ne fund te muajit Nentor, dollari amerikan arriti nivelin 94.13 leke/dollare.

**Kursi mesatar i kembimit te lekut kundrejt dollarit amerikan ne muajin Nentor 2006, arriti ne 96.50 leke/dollare.**

**Kursi mesatar i kembimit te lekut kundrejt Euros ne muajin Nentor 2006, arriti ne 123.99 Leke/Euro**, duke shenuar nje rritje prej 0.62 perqind krahasuar me nje muaj me pare. Ne fund te muajit Nentor nje euro u kembye me 124.10 leke.

Gjate muajit nentor, u konstatua nje nencmim i lekut kundrejt monedhes europiane Euros prej rreth 0.62 perqind dhe nje mbicmim kundrejt dollarit amerikan prej rreth 1.19 perqind.

Ne krahasim me muajin nentor te vitit te kaluar rezulton se monedha shqiptare eshte vleresuar ndaj dollarit amerikan ne masen 7.3 perqind dhe eshte zhvlersuar kundrejt monedhes europiane, Euro me 1.11 perqind.




Nencmimi i lekut, kundrejt monedhes europiane Euro dhe mbicmimi kundrejt monedhes amerikane, ne rradhe te pare eshte i lidhur me ecurine e tyre ne tregjet monetare nderkombetare, duke reflektuar sjelljen e tyre ne tregun e brendshem monetar. Kursi i kembimit te euros me dollarin amerikan pesoi nje rritje mesatare te lehte duke arritur ne rreth 1.285 dollare/euro.

Nder faktoret e brendshem qe kane ndikuar ne ecurine e monedhes vendase gjate muajit gusht permendim: konsolidimi i situates makroekonomike ne vend, efektete e politikes

monetare te ndermare nga Banka e Shqiperise, rritja e besimit te publikut ne sistemin financiar dhe e biznesit tek monedha vendase, shtimit te kreditimit te dhena nga bankat vendase (dhe kryesishte kredive ne valute), shtimin e flukseve hyrese ne valute per shkak te afrimit te festave te fundvitit etj.

**Interesi i huave 12-mujore** gjate muajit nentor pesoi nje renie prej 1.23 perqind, duke arritur ne 13.99 perqind nga 15.22 perqind qe ishte ne muajin shtator. Per kete muaj normat per interesin e huave 6-mujore pesuan nje rritje me 0.41 perqind, krahasuar me nje muaj me pare. Interesi i huave 6-mujore per muajin nentor arriti ne 15.61 perqind.




Normat e interesit te bonove te thesarit gjate muajit Nentor 2006, per bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin perkatesisht, 7.56 perqind, 6.86 perqind dhe 6.23 perqind. Gjate ketij muaji vihet re nje rritje e lehte ne Yield-et e bonove te thesarit per afatet e maturimit 12 dhe 6 - mujore.

## c. Sektori i Jashtëm

### Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për periudhen Janar – Shtator 2006 ishin:

Nje sufiçit i pergjithshem ne bilancin e pergjithshem, prej 152.9 milion usd, rezultat ky i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 533.6 milion usd;
- suficit te Llogarise Kapitale dhe te Llogarise Financiare, prej 358.0 milion usd;
- bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 328.4 milion usd;




Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 533.6 milion usdo ishin nje:




- bilanc tregtar negativ prej 1495.8 milion usd;
- deficit prej 63.3 milion usd ne bilancin e sherbimeve ;
- suficit prej 187.1 milion usd ne bilancin e te ardhurave ;
- suficit prej 838.4 milion usd levizjet e transfertave dhe dergesave.

## d. Sektori Monetar

### Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate muajit Nentor 2006, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, ne rreth 16.3 miliarde Leke krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.




Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte, me rreth 18.2 miliarde Leke dhe renies te mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise me rreth 1.9 miliarede leke.

Ne muajin Nentor sistemi bankar rezulton me nje renie prej 3.4 miliarde Leke ne mjetet valutore neto, krahasuar me muajin (Shtator'06), renie e cila erdhi si rezultat i renies se nivelit te mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise, me 4.3 miliarde Leke si dhe rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 0.9 miliarde Leke.

### Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te muajit Nentor 2006 arriti ne 179.5 miliarde leke. Rritja e teprices së kredise, krahasuar me nje vit me pare shenoi vleren 64.9 miliardë leke, me nje rritje prej rreth 36.2 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjate kesaj periudhe te vitit 2006, ka qene ne rritje, duke vazhduar keshtu trendin pozitiv te nisur qe ne vitin 2005.

Nga struktura e teprices se kredise sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valute, duke perbere rreth 70.6 perqind te totalit te treprices se kredise.

Kete muaj pesha specifike e kredive per individet, pesoi nje rritje te lehte prej 0.2 pike perqindje, duke arritur ne nivelin 33.6 perqind.

## Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), per muajin nentor ka shenur nje rritje prej 0.43 perqind, karahasuar me nje muaj me pare. Kjo oferte arriti ne rreth 638 miliardë lekë në fund të muajit nentor duke shenuar nje rritje prej 60.0 miliarde leke kundrejt nivelit te rregjistruar ne muajin dhjetor 2005. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 13 perqind, duke pesuar ulje te ketij ritmi krahasuar me 18.3 perqind qe ishte gjate muajit qershor 2005, por duhet theksuar qe ka pesua rrijte ne krahasim me nje muaj me pare.




Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, ne fund te muajit nentor arriti ne 22.9 perqind duke shenuar nje renie prej 0.1 perqind e krahasuar me muajin tetor. Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin nentor arriti ne rreth 29.8 perqind, duke qendruar ne te po njejtat nivele krahasuar me muajin tetor'06.

Depozitat ne leke, si perberesi kryesor i ofertes monetare, kane pesuar nje rritje prej 3.2 miliarde leke ne krahasim me muajin tetor 2006. Nje Renie prej rreth 1.1 miliarde leke ne krahasim me muajin tetor 2006 pesuan depozitat ne valute. Norma vjetore e rritjes se tyre ne fund te muajit nentor arriti ne 24 perqind nga 23 perqind qe ishte ne fund te muajit tetor.



Reniea e depozitave në valutë gjatë muajit nentor është mbështetur kryesisht nga renia e depozitave te sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 72.5 përqind të depozitave totale në valutë.

## Depozitat sipas Burimeve

Gjate muajit Nentor 2006:

- Sektori i individeve, zuri nivelin me te larte te depozitave pa afat ne leke me rreth 61.57 perqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 25.83 perqind dhe nga ndermarrjet publike jofinanciare, me 10.70 perqind.
- Individet dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 73.06 perqind dhe rreth 20.18 perqind.
- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.75 përqind e totalit)




- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 81.91 përqind) të depozitave totale prej rreth 491 miliardë lekë ne muajin nentor 2006. Ata ndiqen nga sektori privat (13.02 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (4.11 përqind) dhe autoritetet lokale (0.71 përqind). Institucionet financiare kontribuan me rreth 0.24 për qind ne totalin e depozitave.

- Gjatë muajit nentor 2006, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit dukshem me 2.2 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave me afat ne leke (2.38 miliard leke), depozitave pa afat ne leke me rreth (0.84 miliarde leke) dhe renies se depozitave ne valute me 1.0 miliarde leke.

- Depozitat pa afat ne leke te familjareve, pesuan nje rritje prej rreth 0.30 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne leke te familjareve pesuan nje rritje prej rreth 2.36 miliarde leke.